



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE**

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave
Dega Doganore Vlore

Nr. 474 Prot., date 29.01.2010

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME**

Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit
Departamenti per Kufit dhe Migracionin

Nr. 473 Prot., date 29.01.2010

URDHER

**Per Procedurat e perbashketa te Policise Kufitare dhe Migracionit dhe Sherbimit
Doganor Shqiptar ne P.K.K Vlore.**

Bazuar ne Ligjin Nr.9746, date 04.06.2007" Per Policine e Shtetit", ne Ligjin Nr.8499, date 27.01.1999, "Kodi Doganor ne R.SH". ne Ligjin Nr.9861" date 24.01.2008"Per Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shteteror", ne Regulloren e perbashket te Ministrat te Brendshem nr. 76916, date 09.04.2008, dhe Ministrat te Fianacave Nr.4873/1 date 17.06.2008, per bashkepunimin ndermjet Sherbimit Doganor dhe Policise se Shtetit", Procedurave standarte te punes se Policise se Shtetit, me qellim, rritjen e performances se dy sherbimeve dhe lehtesimin e procedurave te hyrje/daljeve, te shtetasve dhe mjeteve shqiptare dhe te huaja;

Ushtrimin e kontrolleve te perbashketa, te Policise Kufitare dhe Migracionit me Sherbimin Doganor Shqiptar, per zbatimin ne praktike te parimit "nje ndalese – nje kontroll" ne P.K.K. Vlore.

A. Per kontrollin e udhetareve

Shtetasit shqiptare ose te huaj, qe hyjne ose dalin, ne ose nga Republika e Shqiperise, perpunohen ne terminalin e pasagjereve dhe i nenshtrohen kontrollit kufitar/doganor, te njekoheshishem. Per dokumentat e udhetimit, vizen e hyrjes (kur nevojiten) qellimin e udhetimit dhe kontrollin e bagazheve. Ushtronhet cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes:

I. Kontrolli minimal i personave

Kur nje shtetas shqiptar/ i huaj, afrohet ne kabinen e kontrollit dhe paraqet dokumentin e udhetimit, te vlefshem per te udhetuar. Kontrollori i Policise Kufitare dhe Migracionit, se bashku me punonjesin e doganes, bejne kontrollin e vijes se pare.

Kontrolli konsiston ne:

- a)Kqyrjen e dokumentit te udhetimit per rregullsine e tij, behet duke u bazuar ne procedurat e brendeshme se bashku me punonjesin e Policise Kufitare dhe Migracionit.
 - b)Pasaporten(e cila mund te jete e zakonshme, sherbimi ose diplomatike), leje qendrimi (te vendit ku eshte me banim te perkoqshem), vertetim per leje qendrimi.
 - c) Vizen per te cilin behet:
 - 1-verifikimi nese ka vize ne pasaporte,
 - 2-afati i vizes,
 - 3-rregullsia e vizes.
- Punonjesi i Policise Kufitare dhe Migracionit ben rregjistrimin ne sistem.

- d) Shtetasve te huaj i behet verifikimi i shpejte i diteve te qendrimit (dalje).
- e) Gjate rregjistrimit, behet kujdes per te lexuar alarmet qe mund te jape sistemi.
- f) Punonjesi i Doganes ben kontrollin e bagazheve nese gjykoitet e arsyeshme per kontroll te tyre
- g) Pas verifikimeve te mesiperme, vulos dokumentin e identifikimit dhe lejon shtetasin te hyje/dale ne/nga Republika e Shqiperise.
- h) Punonjesi i Poicise Kufitare dhe Migracionit ben rregjistrimin e personit ne sistem.
- i) Gjate regjistrimit, ben kujdes per te lexuar alarmet qe jep sistemi.
- j) Pas veprimeve te mesiperme, vulos pasaporten dhe lejon shtetasin te hyje/dale ne/nga Republika e Shqiperise.
- k) Kur personi i paraqitur ne kabine, rezulton se nuk permbush kushtet e daljes ose te hyrjes, kontrollori shqiptar, refuzon hyrjen/ daljen ne/nga Republika e Shqiperise, duke bere evidentimin perkates ne sistem, si dhe duke plotesuar formularin e parashikuar me kete rast.

Kur gjate kontrollit minimal, kontrollori i P.K.M-se ose punonjesi i doganes, gjykojne se ndaj ketij personi, duhet ushtruar kontroll i detajuar kryejne, veprimet e meposhtme:

- a) Kontrollori i P.K.M, njofton Pergjegjesin e Turnit dhe merr masa per sigurimin e tij.
- Dergon dokumentin e identifikimit per ekzaminim te metejshem ne laborator. Pas verifikimit ne Laborator, vazhdohet procedura ne baze te rezultatit te verifikimit.
- b) Kur nga sistemi jepet mesazhi per “Persona ne kerkim” kontrollori njofton Pergjegjesin e Turnit dhe vepron ne baze te urdherit te tij per sigurimin e personit dhe hartimin e akteve proceduriale per kete rast. c) kur gjate regjistrimit del mesazhi per “pasaporte te pavlefshme”, “te humbur”, “jashte perdonimit”, kontrollori njofton Pergjegjesin e turnit dhe harton procesverbalin e bllokimit te pasaportes.
- d) Kur gjate evidentimit te te dhenave ne hyrje/dalje, shtetasit i refuzohet ajo. Kontrollori e prapson. ben evidentimin ne sistem dhe perpilon procesverbalin e prapsimit/refuzimit (hyrje/dalje).e).Kur nga punonjesi i P.K.M ose i doganes, kerkohet qe personi te shkoje ne ambiente te posacme per kontroll te detajuar, duhet te mbahet parasysh gjinia e personit qe kontrollohet.
- f) Kur udhetaret jane ne grup ne autobus, ata trajtohen si pasagjere te rregullt. Keta pasagjere, duhet te zbresin nga autobuzi dhe te kryejne veprimet per kontroll individual dhe pas perfundimit te procedurave te kontrollit dhe rregjistrimit te P.K.M-se dhe punonjesit te doganes, hipin perseri ne autobuz.
- g) Ne baze te gjykimit, me informacion ose me perzgjedhje, pasagjeret perpunohen ne terminal duke i kaluar nje e nga nje ne kontrollin e P.K.K dhe te doganes. Pas perfundimit te kontrollit, u jepet pasaporta dhe lejohen te hipin ne autobus, per te vazhduar udhetimin.

B.Per kontrollin e autoveturave.

Automjetet shqiptare dhe te huaja, qe hyjne/dalin nga Republika e Shqiperise, nenshtrohen një kontrolli minimal, kontrolli te detajuar dhe cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te analizes se riskut, informacionit dhe perzgjedhjes.

Kontrolli ushtrohet i njekoheshem nga P.K.M dhe Dogana.

Kontrolli i vijes se pare perbehet nga dy faza, kontrolli minimal dhe ai mesatar:

I. Kontrolli i vijes se pare minimal:

Realizohet pa zbritur pasagjeret nga mjeti, ku punonjesi i Policise Kufitare dhe ai i doganes qe operojne ne terren jashtje kabines) dhe ai i doganes,bjejne kontroll minimal qe konsiston ne kontrollin vizual te kabines, numrin e personave qe ndodhen ne makine, gjate kontrollit minimal hapet bagazhi i mjetit dhe kontrollohet nga te dy punonjesit e kontrollit fizik njekohesisht pa i zbritur ato ne toke. Kqyrja e dokumentacionit te mjetit per udhetim dhe konkretisht:

- Dokumentat e mjetit
- Lejen e drejtimit

•Siguracionin e mjetit, mbledhin pasaportat dhe dokumentat e tjera te udhetimit, duke krahasuar dokumentin me poseduesin dhe dokumentat e mjetit me mjetin. Pas nje intervistimi te shkurter mbi gjeneralitetet, qellimin e udhetimit etj, behet rregjistrimi i te dhenave njekohesisht nga punonjesi i policise kufitare ne kabine dhe nga punonjesi i sherbimit doganor, duke leshuar ose mbledhur vertetimin e hyrjes. Gjate kontrollit minimal, hapet bagazhi i mjetit dhe kontrollohet nga te dy punonjesit njekohesisht pa zbritur malli nga bagazhi.

Zhvillohet ne ane te korsise ose ne nje korsie te vecante, ndersa fiket automjeti, zbriten bagazhet dhe pasagjeret zbresin per te qene prezent gjate kontrollit. Gjate ketij kontrolli punonjesit perdonin doreza te vecanta. Deri ne mbarim te ketij kontrolli, dokumentacioni imjetit mbahet nga punonjesit e policise ose te doganes.

2. Kontroll te detajuar te autovetures;

Nese gjate kontrollit minimal, ka dyshime, informacion dhe bazuar ne analizen e riskut kryhet kontroll i detajuar. Grupi i perbashket kryen keto veprime:

- a)I kerkojne drejtuesit te mjetit te drejtoje makinen ne ambientin e ures ngriteset te kontrollit te mjeteve duke u shoqeruar nga nje punonjes policie.
- b)Bejne kontrollin e detajuar te mjetit duke perdonur pajisje te specializuara per kontroll te imet e te sakte qe kane ne perdonim .
- c)Ne kontrollin e detajuar perdoret qeni antidroge dhe mjete te tjera ne perdonim te te dyja agjensive.
- d)Ne perfundim te kontrollit, hartohet nje akt procedural ne baze te rezultatit te kontrollit.
- e) Pas perfundimit te kontrollit dhe rezultatit te arritur.evidentojne ne rregjister kontrollin e bere.

Kur gjate kontrollit evidentohen mallrat e ndaluara, lende narkotike, toksike\psikotrope. veprimet kryhen ne bazet e Kodit te Procedures Penale dhe te Kodit Doganor.

C. Per kontrollin e autobuseve

Autobuzet shqiptare dhe te huaj, qe hyjne/dalin ne/nga Republika e Shqiperise, i nenshtrohen nje kontrolli minimal, kontrolli te detajuar dhe cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes.

Kontrolli ushtrohet i njekohshem nga Policia Kufitare&Migracionit dhe Dogana.. Gjithashtu, ushtrohet cdo lloj kontrolli tjeter, ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes;

1. Kontrolli i vijes se pare:

Kontrolli i pasagjereve qe udhetojne me autobus, ne/nga Republika e Shqiperise, i nenshtrohen nje kontrolli minimal vizual dhe veprimet me dokumentacionin e tyre e kryejne ne terminal si te gjithe pasagjeret e tjere kembesore, pas mbarimit te veprimeve me dokumentacionin ata i nenshtrohen veprimeve te tjera kontrolluese te punojesit te P.K.M dhe punonjesit te doganes qe kryejne veprime ne terminalin e perpunimit te pasagjereve.

Pas perfundimit te veprimeve te regjistrimit te dokumentacionit te pasagjereve, personeli i P.K.M si dhe doganieret kryejne kontrollin minimal apo mesatar te mjetit ne prezencen e te gjithe pasagjereve.

Punonjesi i PKM-se, mbledh pasaportat duke bere numerimin e tyre dhe te pasagjereve, duke bere krahasimin e listes se udhetareve, dokumentit te udhetimit personave. dhe intervistimin ne lidhje me qellimin e udhetimit, etj. Punonjesi i doganes, ben kontrollindhe/ose rregjistrimin e dokumentacionit te mjetit, per Ilogari te doganes. Nderkohe qe, kryhet rregjistrimi i te dhenave

te udhetareve dhe mjetit ne sistem, punonjesi i doganes dhe ai i PKM-se bejne kontrollin minimal ose mesatar te mjetit, si kunder ne kontrollin e autoveturave.

2. Kontrolli i detajuar

Behet ne ambientin e posacem te ngritur per kontroll:

- a) Drejtuesi i mjetit qendron bashke me mjetin, ndersa pasagjeret qendrojne ne terminal.
- b) Grupi qe ben kontrollin e detajuar perbehet nga nje punonjesi P.K.M dhe nje punonjes i Doganes.
- c) Ne kontrollin e detajuar, perdoret dhe qeni antideroge dhe mjetet ne perdomim te te dyja agjensive.
- d) Ne perfundim te kontrollit, hartohen aktet proceduriale ne baze te rezultatit te kontrollit.
- e) Pas perfundimit te kontrollit, te gjitha veprimet e kryera, evidentohen ne rregjister te vecante nga te dy punonjesit per kontrollin e bere.

-Kur gjate ko;trollit, evidentohen mallra te ndaluara, lende narkotike, toksike/psikotrope, veprimet kryhen ne baze te Kodit te Procedures Penale dhe te Kodit Doganor.

D. Per kontrollin e Kamionave

Kamionet Shqiptare dhe te huaj qe hyjne/dalin nga Republika e Shqiperise, i neneshtrohen nje kontrolli minimal, kontrolli te detajuar dhe cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes. Kontrolli ushtronhet i njekohesishem nga Policia Kufitare dhe Migracionit dhe Dogana duke u bazuar ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes:

Behet ne korsine e kamioneve prane kabines se rregjistrimit.

- a) Kontrollohet dokumentacioni i drejtuesit te mjetit nga P.K.M dhe Dogana sipas drejtimit te punes.
- b) Behet kontroll i perfaqshem i mjetit, per te evidentuar demtimet e mbuleses se mjetit ose te fijes se Plumbosur.
- c) Kur cdo gje rezulton e rregullt, lejohet qe mjeti te vazhdoje udhetimin.

2. Kontrolli i detajuar;

- a) Drejtuesi i mjetit bashke me mjetin dergohet ne kontrollin e detajuar. ndersa shoqeruesit e tjere (nese ka) te mjetit. qendrojne ne terminal.
- b) Grupi qe ben kontrollin e detajuar, perbehet nga nje punonjes i P.K.M-se dhenje punonjes i Doganes.
- c) Ne kontrollin e detajuar perdoret qeni antideroge dhe mjetet e tjera ne perdomim te te dyja agjensive.
- d) Ne perfundim te kontrollit hartohen aktet proceduriale ne baze te rezultatit te kontrollit.
- e) Pas perfundimit te kontrollit, te gjitha veprimet e kryera, evidentohen ne rregjister te vecante per kontrollin e bere.
- f) Gjate kontrollit te detajuar, dokumentat e mjetit mbahen nga punonjesit qe kryejne kontrollin te cilet gjate veprimeve perdonin doreza mbrojtese.

Kur gjate kontrollit evidentohen mallrat e ndaluara, lende narkotike,toksiqe, psikotrope, veprimet kryhen ne baze te Kodit te Procedures Penale ose te Kodit Doganor.

Gjate kontolleve te lendesse pare, per te gjitha llojet e mjeteteve eshte i detyrueshem perdomimi i mjeteteve ndihmese si, pasqyra, drita ultravjollce, etj.

Gjate kontrollit qe ushtrohet ne rubriken "INTERPOL" per mjetet e vjedhura, mjeti dhe udhetaret qendrojne ne korsi te vecante dhe gjate procedurave te tjera hetimore, qytetari nuk duhet te jete prezent.

Keto detyra, jane te detyrueshme per tu ndjekur dbe zbatuar nga punonjesit e te dy Agjensive te Zbatimit te Ligjit, te cilat operojne ne P.K.K.Viore, ne te kundert, mbajne perqejegjesi ligjore dhe administrative.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

DREJTORI

VASIL VALERA

DREJTUES

GAZMIR SPAHIJA